



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1918 Prot.

Roskovec, më 28.04 2020

VENDIM

Nr. 30, datë 27.04 2020

PËR MIRATIM REZOLUTE

**MBI MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA PËR SHKAK TË SITUATËS SË KRIJUAR  
SI REZULTAT I PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenin 54, shkronja “k”, 55, pika 2, Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak”, Këshilli Bashkiak Roskovec në mbledhjen e tij të datës 27.04.2020, me propozim të Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Çështjeve Sociale,

VENDOSI :

1. Miratimin e Rezolutës “Mbi marrjen e masave të veçanta për shkak të situatës së krijuar si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga Covid-19, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Menaxhimit të Projekteve Sociale, Koordinimit me BE dhe Shërbimeve Komunitare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Kjo Rezolutë i dërgohet Kryetarit të Bashkisë dhe për dijeni Prefektit të Qarkut Fier.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KOMISIONI PËR BARAZINË GJINORE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Roskovec, më 21, 04 2020

REZOLUTË

MBI MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA PËR SHKAK TË SITUATËS SË KRIJUAR  
SI REZULTAT I PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Roskovec”, duke marrë në konsiderate rolin e Këshillit Bashkiak, si organi mbikqyrës të Njesisë së Qeverisjes Vendore Bashkia Roskovec, si përfaqësues i vullnetit të qytetarëve të Roskovecit;

- Duke ndjekur me shqetësim situatën e krijuar në vendin tonë për shkak të COVID-19;
- Duke qenë të vetëdijshëm, që pandemia amplifikon pabarazitë ekzistuese në drejtim të të drejtave mes grave dhe burrave dhe grupeve të ndryshme sociale, gratë e dhunuara, të identifikuar më herët janë veçanërisht të rrezikuara.
- Duke marrë në konsiderate masat parandaluese dhe ato që vijnë në ndihmë të grupit të grave të dhunuara, Këshilli Bashkiak synon të nxisë dhe mbështesë masa lokale të adaptuara, të cilat janë gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe të drejta, përmes vënies në efikasitet të strukturave dhe burimeve ekzistuese që kanë bashkitë, bazuar në ligjin me poshtë, por jo vetëm:

Ligji Nr. 47/2018 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006, “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, TË NDRYSHUAR:

- Duke vlerësuar të domosdoshme, marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si pasoje e pandemisë nga epidemia COVID-19;
- Duke vlerësuar se viktimat e dhunës në familje janë më të rrezikuara dhe mund të jenë pa mundësi marrje shërbimi;
- Duke vlerësuar përgjegjësitë e bashkisë, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji

**Këshilli Bashkiak, i kërkon Kryetarit/es së Bashkisë :**

- Bashkia të vërë në efikasitet strukturat dhe burimet ekzistuese përkatëse për të kontaktuar.



- Koordinatorët/et Vendorë/e të raportojnë një herë në javë pranë komisionit të barazisë gjinore dhe të mbrojtjes sociale (KBGjÇS) për numrin e viktimave të dhunës të kontaktuara, si masë parandaluese për dhunën.
- Ndërmerr fushata informuese rreth parandalimit të dhunës me bazë gjinore, dhe njohjes së mekanizmave mbrojtës që mund të arrihen dhe të përdoren nga viktimat duke ruajtur sigurinë e tyre.

**ANTAR TË KOMISIONIT**

Aleksander Sheme

Dorinela Hoxha

Leksi Goga

Genci Hoxha

**KRYETAR I KOMISIONIT**

Borana Kuka

